

V E N D I M
Nr. 94, datë 21.3.2002

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2002, MIRATUAR PËR KUVENDIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË
DEKLARIMIT TË PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 "Për deklarimin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik" të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë", si dhe të nenit 7, të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2002", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, t'i shtohet fondi prej 1 980 000 (një milion e nëntëqindetëdhjetë mijë) lekësh, për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik, për vitet 2001 dhe 2002.

2. Shpërblimi të bëhet sipas vendimit nr. 807, datë 24.12.1998, Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e anëtarëve të komisionit të deklarimit të pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", me ndryshimet përkatëse.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2001.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko